



PROCESVERBAL NGA MBLEDHJA E KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE

Mbledhja: Nr. 27

Datë: 20 prill, 2024

Fillimi i takimit: 14:00

Vendi: Selia e KQZ-së/ Prishtinë

Kryesoi: Kreshnik Radoniqi, Kryesues i KQZ

Anëtarët e KOZ-së prezentë: Sami Kurteshi, Alban Krasniqi, Ilir Gashi, Sami Hamiti, Arianit Elshani, Ibrahim Selmanaj, Gordana Llaban, Mufera Shinik, Čemailj Kurtiš, Fazli Stollaj

Nga SKQZ: Burim Ahmetaj, kryeshef i SKQZ; **Nga ZRCKFSP:** Besnik Buzhala, drejtor i ZRCKFSP; **Përkthyes/e:** Argjina Misini; Jehona Cami; **Procesmbajtës:** Fehmi Ajvazi

RENDI I DITËS

1. Hyrje: z.Kreshnik Radoniqi, Kryesues i mbledhjes së KQZ-së
2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit Nr.24/2024
3. Aktivitetet e SKQZ
 - Njoftim lidhur me organizimin e procesit të votimit për apo kundër largimit të kryetarëve të komunave në Leposaviq, Zubin Potok, Zveçan dhe Mitrovicë e Veriut, që do të mbahet më 21.04.2024.
4. Shqyrtimi dhe miratimi i Procedurave të QNR-së
5. Të ndryshme

1.Hyrje: z. Kreshnik Radoniqi, Kryesues i mbledhjes së KOZ-së

Kryetari **Radoniqi**, prezantoi rendin e ditës, dhe pastaj pyeti nëse dikush ka ndonjë propozim, sugjerim etj . Kryeshefi Ahmetaj, tha se në momentet e fundit ka ardhur një propozim nga zyrtarët ekzekutiv të katër komunave veriore për emërimin e menaxherëve të Qendrave të Votimit, dhe stafit teknik. Dhe kjo të jetë në rendin e ditës.

Kryetari Radoniqi e hodhi me votim rendin e ditës, dhe me 10 vota për u miratua rendi i ditës. Pas kësaj, u miratua edhe procesverbali nr, 24 me një votë abstenimi.

2.Aktivitetet e Sekretariatit

Burim Ahmetaj, tha fillimisht se më 03 prill, KQZ ka miratuar listën e Qendrave të Votimit, gjithsej: 43 QV për procesin e votimit për apo kundër largimit të kryetarëve të komunave që do të organizohet me 21 prill 2024. Bazuar në Ligjin 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, në përmbushjen e përgjegjësive ligjore, KKZ –të bashkëpunojë me institucione publike. Sipas formave të bashkëpunimit ligjor, komunat janë të obliguara të ofrojnë mbështetjen e nevojshme për KKZ-tëe në kuptimin e sigurimit të hapësirave për punë, depo për materiale, transport, objektet publike për nevoja të votimit apo ambiente tjera për organizimin e trajnimeve të komisionerëve dhe numëruesve, si dhe hapësira për adaptimin e qendrave komunale të numërimit.

Ne, tha z. Ahmetaj kemi raportuar më 17 prill se nga gjithse 43 QV, nuk janë të qashme 33 Qendra të Votimit. Pra, këto qendra jënë në shkolla dhe i përkasin objekteve publike të komunave Leposaviq, Zubin Potok, Zveçan dhe Mitrovicë e Veriut. Objektet janë refuzuar nga drejtorët e shkollave prandaj, jemi detyruar të gjejmë lokacione alternative të cilat do të shërbejnë si QV në ditën e votimit, më 21 prill. Pra, jemi duke bërë përpjekje maksimale për hapjen e të gjitha Qendrave të Votimit dhe Vendvotimet.

Drejtori Ahmetaj, informoi se janë 23 QV, 63 Vendvotime, ndërsa 4 QV janë me kusht. Kurse, 7 QV, për shkak të hapësirës, do të menaxhohen nga një trup i KVV. Si në vijim:

Në Objektivin Komunal – Soqanicë janë QV 1211, 1214 të cilat do të menaxhohen nga një trup zgjedhor (KVV).

Në Objektivin shtetëror – Dren – Laposaviq janë QV 1205, 1209, 1212 të cilat do të menaxhohen nga një trup zgjedhor (KVV).

Në Objektivin i NSH Univerzal – Leshak - Laposaviq janë QV 1210, 1213, 1215 të cilat do të menaxhohen nga një trup zgjedhor (KVV).

Në Objektivin Privat – Laposaviq afër stacionit të Autobusave janë QV 1208, 1216, 1217 të cilat do të menaxhohen nga një trup zgjedhor (KVV).

Në Objektivin Publik Mala Jabuka - Zubin Potok janë QV 2804, 2812 të cilat do të menaxhohen nga një trup zgjedhor (KVV).

Në Objektivin Publik Te Ura e Bubës - Zubin Potok janë QV 2805, 2806 të cilat do të menaxhohen nga një trup zgjedhor (KVV).

Në Objektivin Publik në Bërnjak - Zubin Potok janë QV 2807, 2810 të cilat do të menaxhohen nga një trup zgjedhor (KVV).

Në vazhdim, drejtori i Sekrteriatit numëroi edhe aktivitetet e prokurimit që tha se, nga 21 aktivitete të prokurimit të planifikuara për procesin e votimit të 21 prill 2024, janë realizuar tetë (8) aktivitete. Për dy aktivitete, është bërë vlerësimi nga komisioni vlerësues. Ndërsa në vlerësim e sipër, është një aktivitet. Në proces janë shtatë (7) aktivitete. Në proces të ofertave, janë tre (3) aktivitete. Aktivitete të cilat janë në proces janë kryesisht aktivitete ku katër (4) prej tyre kanë filluar më herët, dhe tre (3) prej tyre, për shkak të procedurës emergjente ekstreme.

Cështja e trajnimeve, është kryer sipas planit; Programit Orientues për anëtarët e Komisionit Komunal të Zgjedhjeve, u realizuara me datën: 30.03.2024. Tema kryesore, ishte: “Roli, të drejta dhe përgjegjësitë e anëtarëve të KKZ-ve në Procesin e Votimit të 21.04.2024”. Zhvillimi i këtij programi i cili, aplikohet për çdo palë zgjedhje, ka për qëllim njoftimin më për së afërmi me rolin, të drejtat dhe me obligimet ligjore që i kanë anëtarët e KKZ-ve gjatë mandatit të tyre në KQZ.

Me datën 15.04.2024, është zhvilluar trajnimi për stafin e angazhuar si trajner për trajnimin e TMZ-ve në terren. Tema e trajnimit, ka qenë: “Procedurat e votimit dhe numërimit në VV dhe Pranim dorëzimi i materialeve nga KVV në KKZ, për procesin e votimit për apo kundër largimit të Kryetarëve nga funksioni në katër komunat e veriut”.

Për risitë dhe ndryshimet e bazuara ne rregullat zgjedhore, shtjellim më i dukshëm u bë në këto sesione: 1. Procedurat e votimit te rregull u njoftuan dhe pasuan ushtrime ne aspektin praktik për çështjet si ne vijim: Përdorimi i lapsit matrikulues, ndarja e VV te rregullt nga ai me kusht, pranimi i stikereve për VV dhe Kutit te votimit te gatshëm te shtypur paraprakisht me kodet përkatëse, përdorimi i kamerave regjistruese ne VV etj. 2. Procedurat e votimit me kusht, duke prezantuar programin e hartuar nga TI. 3. Formulari i rezultateve i cili dalluar nga proceset e kaluara ka pësuar një reduktim te materialeve dhe evidencave nga proceset e kaluara, ku nder te tjerash janë larguar rubrikat e Votimit me kusht, sepse ky proces në të ardhmen do të zhvillohet si i ndarë nga VV e rregullta. 4. Procedurat e paketimit të cilat gjithashtu kanë pësuar reduktim dhe specifikime të artikujve gjatë paketimit dhe procedimit të tyre nga KVV ne KKZ. 5. Procedurat e pranim dorëzimit, u shqyrtuan dhe diskutuan ne aspektin e risive te cilat do te aplikohen ne këtë proces për herë të parë. 6. Vlen të theksohet se, aplikimi i kamerave regjistruese në këtë proces, do të jetë për herë të pare.

Ahmetaj, si aktivitet tjetër, potencoi trajnimet në terren. Më 16 prill, tha ai, ka filluar procesi i trajnimit për anëtarët e KVV në komunën e Zubin Potok. Tema qendrore e trajnimit ka qenë: “Procedurat e votimit dhe numërimit për procesin e votimit për apo kundër largimit të kryetareve nga funksioni ne katër Komunat e veriut.” Trajnimet/seancat u zhvillua kryesisht ne objektet publike siç janë shtëpitë e kulturës, salla për media, salla te kuvendeve komunale etj. Agjenda e trajnimit për procedurat e votimit dhe numërimit ne VV ishte e planifikuar te zgjate: 3 deri ne 4 ore. Vlen te theksohet se, ne disa seanca është dashtë te korrigojohet agjenda, për arsye se, personat e emëruar si anëtar te KVV-ve te cilët e kane te obliguar ti ndjekin trajnimet, është shtruar nevoja te përshtatet orari ne orët e pasdites sepse, disa prej tyre ishin te punësuar ne administratën shtetërore.

Bazuar në raport, Sekretariati po bënë përpjekje që votimi më 21 prill, jo vetëm të mbahet por, ai të zhvillohet pa probleme që, do ta pengonin zhvillimin e duhur të këtij procesi. Kështu, sipas raportit në Zveçan – janë planifikuar të trajnohen 49 anëtarë të KVV. Të trajnuar janë 41 anëtar, ndërsa në mungese të 8 anëtarëve të KVV që nuk kanë marrë pjesë në trajnim, janë zëvendësuar me 8 zyrtar tjerë nga ARC të cilët, trajnimet i kanë ndjekur në komunën e Mitrovicës se veriut (gjithsej te trajnuar 41). Në Leposaviq, janë planifikuar të trajnohen 84 anëtarë të KVV. Janë trajnuar 80 anëtar të KVV-ve, ndërsa prej numrit të gjithmbarshëm, të planifikuar kanë qenë 84

anëtar, ku prej tyre janë dorëhequr 4 anëtar nga partia PKS (gjithsej te trajnuar 80). Në komunën e Zubin Potokut janë planifikuar të trajnohen 74 anëtarë të KVV. Deri me sot janë trajnuar 64 anëtar, ndërsa te planifikuar kanë qene 74 anëtar. Nga 74 sa ishin te planifikuar, 10 anëtar nga partia Gradjanska Iniciativa, janë dorëhequr dhe nuk kane vijuar trajnimet fare (gjithsej te trajnuar 64).

Dhe në komunën Mitrovica e veriut, janë planifikuar të trajnohen 130 anëtarë të KVV. Deri më sot, ka thënë z. Ahmetaj, janë trajnuar 113 anëtar te KVV-ve, 3 ekipe mobile me 9 anëtar dhe 8 anëtar te KVV te angazhuar nga ARC e qe KQZ i ka angazhuar ne komonat tjera (gjithsej te trajnuar 130).

Drejtori Ahmetaj, në fund ka thënë se janë trajnuar 315 anëtar për katër komonat ku do të mbahet votimi, dhe gjithashtu, në KQZ është zhvilluar trajnim edhe për 13 kryesues të KVV-ve (ZE KKZ) të emëruar nga KQZ për tu angazhuar në ditën e votimit.

Numri i gjithmbarshëm i të trajnuarve, është: 328 anëtar te KVV, ka thënë në fund z. Ahmetaj.

Pas raportimit mbi aktivitetet e Sekretariatit, kryetari Radoniqi pyeti anëtarët nëse ka dikush për të thënë, a diskutuar.

Ilir Gashi, pyeti mbi atë se janë proceduar në KQZ 43 qendra. Ndërsa në mbledhjen e mbajtur “on – linë” qendrat janë zvogëluar nga 43 në 23. Pse nuk janë hapur 43 qendra, pavarësisht se drejtorët kanë deklaruar se nuk i “hapim”! Pyetja tjetër: A janë shtjerrë të gjitha komunikimet, pyetjet dhe komunikimet me institucionet relevante si Ministria e Brendshme ?

Jemi kthyer në “kantonier”, si në vitin 2009... Pse të mbahen në kantoniere ? Kam votuar kundër, edhe në këtë mbledhje “on – linë”. Pse të ketë qendra alternative, të bëhet reduktimi i tyre, apo a janë kontaktuar institucionet përgjegjëse që të hapen aty ku duhet, dhe ku i kemi miratuar qendrat...

Alban Krasniqi, nuk e përkrahu diskutimin e z. Gashi, nuk u pajtua me qëndrimin e tij dhe tha se ekziston hierarkia e institucioneve; Ka pasur përpjekje, dhe duhet kërkuar që komonat janë përgjegjëse si në këtë rast kur objektet janë në pronësi të tyre, dhe ata duhet ti adresojnë në prokurori rastet... Z. Krasniqi, diskutoi gjatë dhe tha në fund se, interesi i Kosovës është që atje të zhvillohet procesi, dhe jo të dështohet...

Z. Gashi, nuk u pajtua me diskutimin e z. Krasniqi. Ai, shtroi përsëri pyetje se, a janë shterë të gjitha mundësitë, përpjekjet...!

Gordana Llaban, pyeti se ‘a e kemi shtuar numrin e votuesve në Vendvotime sepse, ka më tepër se sa që ne kemi miratue’ dhe, ajo që unë e përshëndes është se qytetari atje e di se ku duhet të votojë sepse, nuk e kisha të qartë...!

Sami Hamiti, tha se KQZ e ka kryer punën e vet. Absolutisht. Herën e kaluar kishim një situatë tjetër, tani kemi një situatë tjetër. Tani, ne e kemi ditur me kohë se kryetarët e komunave nuk do t’ëmund ta ushtrojnë funksionin e tyre, kurse tani, edhe mund të hapen me forcë, por KQZ e ka krye punën e vet. Lista Serbe, e ka shantazhuar procesin, e dimë të gjithë se atje nuk ka siguri!

Ne, është dashur të kishim komunikim, e unë nuk e kam pa...!

Alban Krasniqi: Ka, por nuk je kanë këtu...

Čemailj Kurtiš: Pajtohem me një pjesë të diskutimeve. Nuk është me rëndësi kush është atje, ne duhet të koncentrohemi në proces. Ta ndihmojmë Sekretariatit, dhe sa të jetë e mundur të koncentrohemi në detyrat tona.

Burim Ahmetaj, ndër të tjera, tha se janë bërë komunikimet me institucionet relevante për organizimin e procesit. Asnjë vendvotim nuk është shkruar me vendvotim tjetër, secili vendvotim është autonom, me përjashtim të rastit kur një trupë do ti menaxhojë ato vendvotime që i kam përmendur në raport. Numri i votuesve, nuk e kalon “950”-in !

Arianit Elshani: Mendoj që interesa të tjera nuk ka, veç organizimit dhe procesit të votimit! Ju e dini qëndrimin tonë ndaj gjithë procesit, e edhe të Ilirit. Por kemi qenë konsistent në përgjegjësitë tonë për organizimin e procesit. Nuk e kemi bojkotuar apo minuar procesin! Por po ndalem në një çështje tjetër: në Leposaviq, lidhur me emërimin e 8 anëtarëve të KVV-e, e që ata janë asamblisti, dhe janë ftuar në trajnime. Prandaj, emërimi i tyre është në kundërshtim me ligjin. Kërkoj që ata të tërhiqen. Nuk dëmtohet numri i përgjithshëm.

Burim Ahmetaj: E kemi rekomanduar këtë çështje të asamblastëve...

Alban Krasniqi: Kur bëhet rekomandimi, duhet cituar – treguar nenin saktë që thotë se, asamblasti nuk ka të drejtë me qenë anëtarë komisioni, sepse nuk cenohet interesi i asnjë asamblasti, nëse veç nuk është kandidat për asamblastë. Prandaj, duhet me qenë më konstruktivë, dhe interesat

afatshkurtër politike të mos vihen në pah. Dje ka pas një dezinformatë që ka dalë në media nga këtu, se komisionarët e një subjekti janë tërhequr e që ka dalë si jo e vërtetë ! Pra, kjo është lufta speciale, hibride...

Nuk i mirëkuptoj këto qasje. Ta lëmë Sekretariatën ta kryej punën e tij politikën – kur të dalim në kafe...

Sami Kurteshi: Nuk habitem, ne jemi trupë ekzekutive por nuk jemi jashtë politikës! Unë, si përfaqësues i VV-së, dhe kam lojalitet politik ndaj subjektit tim! Por, kam lojalitet institucional ndaj KQZ-së si anëtarë! Janë reduktuar qendrat, sepse 45 ditë përpara kemi thënë se mbahen votimet, dhe pastaj disa drejtorë pastaj, kanë caktuar aktivitete kulturore. Pra, për të shkaktuar incidente. Vuçiqi, i ka manipuluar zgjedhjet në Serbi, e pse të mos i manipuloj zgjedhjet në Kosovë. Pra, që rasti të përfundoj në Këshillin e Sigurimit...

A jemi si KQZ me e dështua këtë proces ? Po, lista Serbe është në lojë, por nuk do ta qojë përpara synimin e saj. Vuçiqi, i ka manipuluar zgjedhjet në Serbi, dhe ajo mostër po përdoret këtu! Për mua, lista serbe është organizatë terroriste! Por nuk vepron prokuroria, edhe pse ka bërë veprime...

Arianit Elshani: Po flas tani në emër të PDK-së: ne jemi aty, dhe do të jemi edhe nesër...!

Ibrahim Selmanaj, tha ndër të tjera se, ‘Albani duhet të ketë kujdes në raport me kolegë, pa cilësime’ sepse, ne jemi në proces dhe nesër kemi me përfundue...

Alban Krasniqi: Nuk ka pasur shprehje që po aludoni, dhe është edhe stenogrami, edhe procesverbali! Unë jam kundër një sjellje formale, porse dami me qenë shumë më i madh. Atë që e mendoj, e them. Nuk kishte shprehje që emri im të jetë referencë!

Në vazhdim, u zhvillua një polemikë në mes të kryetarit Radoniqi dhe Alban Krasniqi. Diskutohet pa rend...

Në vazhdim **Ilir Gashi** tha se nuk është çështja te individi, procesi ka marrë rrjedhë...! Por, nëse ju keni pasur komunime të fshehta, ne si kemi pasur. Është vendosur për qendra alternative pa kurrfarë shpjegimi. Drejtorët nuk janë autoritet që e hap dhe e mbyll shkollën në fund të ditës!

3.Shqyrtimi dhe miratimi i procedurave të QNR

Burim Ahmetaj, raportoi lidhur me procedurat e QNR. Sekretariati, tha ai, ka përgatitur procedurat e QNR. Pranimi, do të respektohet për çdo material të pranuar, dhe ato nuk ndërrojnë, kurse procesimi të dhënave, numërimi ka pësuar ndryshim, thjeshtësim, por, kuptohet, në raport me rregulloren e re. Lokacionet e QNR-së, do të vëzhgohet nga kamerat...

Sami Kurteshi, pyeti se ‘sa persona janë me nevoja të veçanta, sa prej jashtë, sa tavolina pritjet me u hap, kur vijnë fletëvotimet në QNR...?’

Burim Ahmetaj: Janë 2 vota me postë për votim nga jashtë, procedimi do të bëhet shpejt, besojmë brenda një dite...

Kreshnik Radoniqi: Kush është për miratimin e procedurave të QNR ?

Me vota unanime, u miratuan procedurat e QNR-së.

4. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës për menaxher dhe staf teknik të qendrave të votimit

Burim Ahmetaj, tha se Sekretariati ka pranuar listat e menaxherëve dhe të stafit teknikë. Kështu që, kjo listë duhet të miratohet.

Me dhjetë vota për, dhe një abstenim (Gordana Llaban), u miratua lista e menaxherëve dhe e stafit teknik

5. Të ndryshme!

Sami Hamiti: Një pyetje direkte për Sekretariatit: nesër në mëngjes a do të hapen të gjitha QV-të, a është siguruar materiali zgjedhor dhe sensitiv, trupat zgjedhore a i mbulojnë të gjitha vendvotimet...?

Arianit Elshani, kërkoi që të publikohet plani i konferencave në mënyrë që, qytetarët, opinionin dhe të tjerët të jenë të njoftuar me kohë.

Burim Ahmetaj: I gjithë plani operacional i zgjedhjeve është zbatuar, dhe do të zbatohet dhe nesër, në ora 7:00, në mëngjes të jenë gati dhe procesi i votimit të fillojë...

Në fund, kryetari Radoniqi, komunikoi një mesazh për opinionin duke bërë të ditur se “KQZ përkundër sfidave, është organizuar dhe përgatitur për votimin e nesërm”. Qendrat e votimit, do të hapen në ora 7:00. Lista e QV, është publike në ueb faqen e KQZ.

“Ftoj të gjithë qytetarët që të shfrytëzojnë të drejtën kushtetuese të votojnë! Uroj një proces të qetë”, tha në fund kryetari Radoniqi.